



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE

MANUAL UDHËZUES PËR KOORDINIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA NË NIVEL VENDOR

Tiranë, Korrik 2019

**MANUAL UDHËZUES
PËR KOORDINIMIN E
FINANCIMEVE TË HUAJA
NË NIVEL VENDOR**

Tiranë, Korrik 2019

PËRMBAJTJA

I.	<u>KUADRI STRATEGJIK PËR KOORDINIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA</u>	5
1.1.	<u>Kuadri Strategjik dhe Institucional</u>	5
1.2.	<u>Kuadri Ligjor</u>	8
II.	<u>PROCEDURAT PËR SIGURIMIN E FINANCIMIT TË HUAJ</u>	11
2.1	<u>Procesi dhe hapat për sigurimin e financimit të huaj</u>	11
2.2	<u>Tipologjia e projekteve për financim të huaj</u>	15
2.2	<u>Procesi i negocimit dhe miratimit të Marrëveshjeve Qeveritare</u>	18
2.4	<u>Partnerët për Zhvillim dhe Integrim dhe programet e tyre</u>	21

Hyrje: Mbi qëllimin e manualit

Qëllimi i këtij manuali është të udhëzojë dhe orientojë stafin e strukturave të Integritit Europian të ngritur në çdo bashki me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 450 datë 26.07.2018, në përmbushjen e misionit të tyre për koordinimin dhe bashkërendimin e financimeve të huaja në nivel vendor. Ky manual informon mbi procedurat dhe mekanizmat me anë të të cilave mund të sigurohet financimi i huaj në mbështetje të prioriteteve dhe politikave në nivel vendor.

Udhëzimet mund të përdoren gjithashtu nga zyrtarë dhe struktura të tjera përgjegjëse në nivel vendor, si dhe nga palët e interesuara të komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile.

Udhëzimet paraqiten në dy pjesë. Pjesa I siguron një panoramë të përgjithshme mbi kuadrin strategjik dhe procesin e koordinimit të ndihmës së huaj në nivel qëndror. Strukturat institucionale përgjegjëse për bashkërendimin e procesit, kuadri ligjor dhe Instrumentat financiarë kryesorë të Partnerëve për Zhvillim dhe Integrim në mbështetje të projekteve dhe prioriteteve kombëtare.

Pjesa II konsiston në një udhëzues praktik për rrugën që duhet të ndiqet në identifikimin e nevojës për financim, koordinimin e brendshëm ndër-institucional, përgatitjen e dokumentacionit deri në sigurimin e financimit të huaj për projektet me rëndësi në nivel vendor.

Pjesa II përfshin gjithashtu informacionin mbi Partnerët për Zhvillim dhe Integrim kryesorë në Shqipëri, strategjitë dhe programet e ndihmës si dhe agjencitë e tyre të zbatimit.

I. KUADRI STRATEGJIK PËR KOORDINIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA

1.1. Kuadri Strategjik dhe Institucional

Kuadri Strategjik bazë mbi të cilin ngrihen dhe zbatohen politikat dhe proceset për një menaxhim me efektivitet dhe eficiensë të ndihmës së Huaj është Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI) miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave që në vitin 2005.

SPI synon të sigurojë koherencën, efektivitetin dhe harmonizimin në planifikimin strategjik, në financat publike dhe monitorimin e politikave. Në mënyrë më specifike, SPI garanton koherencën ndërmjet Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), strategjive sektoriale dhe ndër-sektoriale afatgjata dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Proceset themelore të Sistemit të Planifikimit të Integruar janë:

- ▶ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI)
- ▶ Programi Buxhetor- Afatmesëm (PBA)
- ▶ Integrimi European
- ▶ Ndihma e huaj

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI), përfaqëson dokumentin strategjik themelor të Shqipërisë, ku definohen vizioni afatgjatë dhe prioritetet strategjike të zhvillimit kombëtar të harmonizuara me objektivat e procesit të Integritimit European. SKZHI sintetizon qëllimet, politikat dhe prioritetet e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të hartuara në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar.

Programi Buxhetor afatmesëm (PBA), vendos një planifikim tre vjeçar shpenzimesh të duhura për të arritur zbatimin e objektivave të politikës sektoriale, si hap i ndërmjetëm për të përmbushur qëllimet madhore të SKZHI-së. SKZHI-ja ndihmon procesin e buxhetimit afatmesëm, duke ofruar një udhëzim afatgjatë për shpërndarjen e burimeve dhe të shpenzimeve të sektorëve të ndryshëm.

Procesi i Integritimit European prek të gjithë komponentët e SKZHI-së të detajuara në Planin Kombëtar për Integrimin European 2019–2021, i përditësuar. Ky plan përmban angazhime të shprehura qartë për fushën e politikave dhe atë legislative të cilat reflektohen në prioritetet për financime si nga IPA ashtu edhe donatorë të tjerë.

Bashkërendimi efektiv i financimeve të huaja me përparësitë strategjike kombëtare dhe procesin e planifikimit të buxhetit është objektivi kryesor i Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI). Përparësitë e SKZHI-së dhe procesi i PBA-së janë baza për programimin e Instrumentit të Para-aderimit (IPA) dhe financimit të ofruar nga donatorët. Që prej vitit 2004, Koordinimi i asistencës së huaj në nivel sektori mbështetet nga ana e Grupeve Sektoriale të Punës të përbërë nga përfaqësues të qeverisë dhe donatorëve.

Sistemi i Planifikimit të Integruar zbatohet nëpërmjet disa strukturave institucionale si në nivel drejtues dhe vendimmarrës ashtu edhe në nivel koordinues e zbatues.

Strukturat kryesore vendimmarrëse dhe koodinuese të SPI janë:

- ▶ Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS)
- ▶ Grupet për Menaxhimin e Integruar të Politikave (GMIP)
- ▶ Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri (DZHM)
- ▶ Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
- ▶ Ministria për Evropën dhe Punërt e Jashtme (MEPJ)

- *Komiteti i Planifikimit Strategjik*, është institucioni më i lartë vendimmarrës për përcaktimin e prioriteteve dhe shpërndarjen e financimeve; KPS miraton programet strategjike dhe projektet prioritare për financimin e huaj në çdo sektor.
- *Grupet për Menaxhimin e Integruar të Politikave*, sigurojnë menaxhimin dhe bashkërendimin e politikave të fushave prioritare dhe të sektorëve me rëndësi të veçantë, si dhe programimin ndërsektorial. Nëpërmjet këtyre grupeve sigurohet koordinimi dhe monitorimi i asistencës së huaj në nivel sektori.
- *Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes*, në Kryeministri, luan rolin e sekretariatit teknik të Komitetit të Planifikimit Strategjik si dhe të Sekretariatit të Përgjithshëm për koordinimin në nivel qendror të mekanizmit të menaxhimit sektorial/ndërsektorial të integruar.

I. KUADRI STRATEGJIK PËR KOORDINIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA

- *Ministria e Financave dhe Ekonomisë*, siguron bashkërendimin eficient të ndihmës së huaj në përputhje të plotë me Prioritetet Strategjike të Vendit dhe të integruar me burimet e brendshme financiare (PBA).
- *Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme*, koordinon dhe drejton gjithë procesin e Integritit Evropian si dhe luan rolin e Koordinatorit Kombëtar për menaxhimin e fondeve të BE-së –IPA (National IPA Coordinator-NIPAC).

Synimi final është maksimizimi i kontributit të ndihmës së huaj drejt arritjes së prioritetëve të politikave kombëtare. Për këtë qëllim Sistemi i Planifikimit të Integruar siguron:

- Koherencën e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) me PBA-në përmes miratimit të një kuadri makroekonomik afatmesëm, që përfshin prioritetet e politikave, financimin e huaj të parashikuar apo programuar, si edhe aspekte të tjera lidhur me shpenzimet dhe të ardhurat.
- Lidhjen e plotë midis planifikimit të financimit të huaj me strategjitë sektoriale e ndërsektoriale, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Kjo siguron që aktivitetet, masat dhe angazhimet e propozuara për financim kontribuojnë në realizimin e politikave dhe objektivave strategjike.
- Lidhjen e plotë midis planifikimit të financimit të huaj dhe objektivave të integritit evropian përkthyer në masa konkrete nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian dhe raportet vjetore të progresit të KE-së.

1.2. Kuadri Ligjor

Konsultimi paraprak me kuadrin ligjor është shumë i rëndësishëm përpara ndërmarrjes së çdo hapi për sigurimin e financimit të huaj.

Në mënyrë specifike duhet ti referohemi:

- Ligjit nr. 43”datë 21.04 2016 “Për Marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj, në nenin Neni 9 “Zhvillimi i negociatave”, ndër të tjera përcakton që në rastet e marrëveshjeve ndërkombëtare të huasë dhe granteve komunikimi ndërmjet palëve mbahet vetëm nga ministri i Financave. Para zhvillimit të negociatave Minsitria e Financave dhe Ekonomisë ndërmerr gjithë procesin konsultues me institucionet qendrore dhe vendore për përcaktimin e prioriteteve sektoriale dhe programeve/projekteve për financim të huaj.

- VKM nr.775 datë 24.09.2010 “Për Administrimin e Financimeve të Huaja në Republikën e Shqipërisë”¹.

Ky vendim, detajon të gjitha hapat që duhet të ndërmerren që nga identifikimi i prioriteteve dhe nevojave për financim, procesin vendimarrës si dhe rolin e institucioneve në planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e financimeve të huaja. Gjithashtu vendimi përcakton hapat që duhet të ndiqen për negocimin, miratimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të financimit të huaj me Partnerët për Zhvillim dhe Integrim.

- Urdhëri i Kryeministrit nr.157 datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Ky urdhër përcakton mjetet dhe mekanizmat për një planifikim të integruar të politikave publike, duke siguruar një shpërndarje efçente dhe efektive të burimeve financiare. Në bazë të tij janë ngritur Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) në pesë fusha prioritare² dhe Komitetet Drejtuese Sektoriale (KDS) në pesë sektorë të rëndësishëm të veçantë në dialogun me BE³.

Ndër të tjera urdhëri përcakton rolin qendror që duhet të luajnë këto grupe për bashkërendimin e planifikimit, prioritizimit, programimit dhe monitorimit të asistencës së huaj për sektorët e përfshirë (kryesisht në nivelin e grupeve tematike), nëpërmjet organizimit të dialogut të rregullt dhe bashkëveprimit me Partnerët për Zhvillim dhe Integrim.

1 Me kalimin e funksioneve të koordinimit të donatoreve tek MFE , VKM nr. 775 date 24.09.2010 do të rishikohet.

2 (i) Mirëqeverisja dhe administrimi publik; (ii) Konkurrueshmëria dhe investimet (iii) Punësimi dhe aftësimi; (iv) Menaxhimi i integruar i tokës; (v) Menaxhimi i integruar i ujit.

3 (i) Reforma në Drejtësi; (ii) Punët e brendshme; (iii) Menaxhimi i financave publike; (iv) Ndërlidhja; (v) Mjedisi, klima dhe menaxhimi i mbetjeve.

Në rastin e financimeve me kredi kuadri ligjor bazë është:

- Ligji 9665 datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”.

Ky ligj, në Nenin 9 “Kufizimet e borxhit shtetëror dhe të garancive shtetërore të huave”, ndër të tjera përcakton që “kufizimet për shumën e borxhit shtetëror dhe për shumën e garancive shtetërore të huave përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit”.

Nisur nga ky rregull, cdo kërkesë për financim të huaj me kredi por edhe me grante duhet detyrimisht të planifikohet dhe jetë pjesë e procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm si dhe të buxhetit vjetor.

Në nivel vendor, kushtet dhe rregullat për financimet e brendshme dhe të huaja rregullohen në mënyrë specifike me ligjet e mëposhtme:

- Ligji nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
 - Neni 39: **Huamarrja vendore**
 - Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin hua, në përputhje me legjislacionin që rregullon menaxhimin e sistemit buxhetor, huamarrjen vendore dhe financat vendore.
 - Aksesit në tregun e borxhit të jashtëm rregullohet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe entitete të tjera, të përcaktuara me ligj
- Ligjin nr.68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”
 - Neni 32: **Planifikimi Strategjik**
 - **Plani Strategjik i Zhvillimit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore**
 - a) përmban politikat për zhvillimin e qëndrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shtrihet në një afat kohor jo më pak se 5 vite;
 - b) merr në konsideratë nevojën dhe potencialet e zhvillimit vendor si dhe prioritetet rajonale e kombëtare të zhvillimit strategjik.
 - c) zbatohet nëpërmjet programit buxhetor afatmesëm të njësisë vendore.

II. PROCEDURAT PËR SIGURIMIN E FINANCIMIT TË HUAJ

2.1 Procesi dhe hapat për sigurimin e financimit të huaj

Financime të huaja – konsiderohen të gjitha ato burime financiare që i jepen Qeverisë Shqiptare ose institucioneve të tjera qeveritare publike, në formën e kredive ose ndihmave nga institucione financiare ndërkombëtare, qeveritë e vendeve të ndryshme nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse.

Tipologjia e financimeve të huaja:

- ▶ Kredi (hua)–janë financime të marra me kusht kthimi me ose pa interes që jepen nga institucione financiare të huaja mbi bazën e marrëveshjeve të kredisë.
- ▶ Ndhmë (grant)– janë financime në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, që jepen nga institucione financiare, organizma të huaja, qeveri të vendeve të tjera, mbi bazën e marrëveshjeve ose protokolleve të bashkëpunimit.

Procesi për sigurimin e një financimi të huaj duhet të ndjekë procedurat që përcaktohen në kuadrin ligjor të përshkruar më lart si dhe në përputhje me përgjegjësitë dhe rolet e çdo institucioni.

Aktualisht nuk egziston një rregullore e posacme për mënyrën se si Bashkitë duhet ti qasen institucioneve qendrore për të përfituar nga financimet e huaja. Për këtë arsye procesi i përshkruar në këtë manual orienton bashkitë që të bazohen në procedurat standarte që cdo institucion shtetëror qendror duhet të ndjekë dhe që rrjedh nga zbatimi i kuadrit ligjor dhe aktet e tjera rregullatore.



HAPI I PARË

Hapat që duhen ndjekur për të siguruar një financim të huaj:

Identifikimi i nevojës për financim bazuar në prioritetet e Programit Strategjik Zhvillimor të Bashkisë apo prioritetet e tjera që rrjedhin nga dokumenta zhvillimorë të Bashkisë apo Qarkut si dhe nga konsultimet me komunitetin, grupet e interesit dhe shoqërinë civile!

Bazuar në nenin 28 të Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, bashkitë janë përgjegjëse për Hartimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit si dhe të programeve për zhvillimin ekonomik vendor. Gjithashtu ato janë përgjegjëse për konsultimin e planeve strategjike dhe Programit Buxhetor Afatmesëm me komunitetin dhe grupet e interesit. Për të garantuar besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e financimeve çdo kërkesë për financim të huaj duhet të jetë në linjë me prioritetet e përcaktuara në këto dokumenta si dhe të përfaqësojë interesat e komunitetit.



HAPI I DYTË

Përgatitja e projekt-idesë me të gjithë elementët e rëndësishëm që duhet të përmbajë një projekt i mirë, cilësor dhe i besueshëm për financim!

Përgatitja e projekt-idesë është vetëm fillimi i procesit dhe ndihmon në qartësimin e ndërhyrjes që synohet të realizohet nëpërmjet financimit të huaj. Projekt-idetë duhet të përmbajnë elementet bazë mbi të cilat do të vlerësohet dhe vendoset dhënia e financimit si: Koherenca me prioritetet strategjike dhe politikat sektoriale, matura konceptuale ku nënkuptohet përcaktimi i qartë i objektivave, synimeve, aktivitetet dhe indikatorë të rezultateve që do të arrihen.



HAPI I TRETË

Konsultimi i brendshëm me të gjitha strukturat e përfshira dhe nivelet vendimmarrëse në Bashki dhe miratimi i listës së projekteve prioritare!

Konsultimi i brendshëm është një moment shumë i rëndësishëm që mundëson kontributin e gjithë strukturave në përgatitjen e projekt-idesë. Kjo do të sigurojë gjithashtu që projekti të ketë mbështetjen e duhur dhe garantojë suksesin në zbatim. Konsultimi mund të përfshijë shqyrtimin e disa projekt-ideve dhe në fund hartohet lista e projekteve prioritare që miratohet nga bashkia e cila është bazë për identifikimin e burimeve dhe sigurimin e financimit të huaj.



HAPI I KATËRT

Konsultimi dhe miratimi paraprak i projekt idesë nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV)!

AMVV si struktura përgjegjëse për mbështetjen e politikave dhe prioriteteve në nivel vendor do të duhet të sigurojë përputhshmërinë e prioriteteve të Bashkisë me programet dhe prioritetet strategjike për decentralizimin dhe zhvillimin vendor, si dhe me strategjitë/projektet e zhvillimit kombëtar. Roli i AMMV është kyç në harmonizimin e ndërhyrjeve në nivel vendor me ato kombëtare si dhe ndërmjetëson me institucionet e tjera për sigurimin e financimeve.



HAPI I PESTË

Përgatitja e kërkesës zyrtare për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ku të shpjegohet nevoja për financim të huaj!

Dërgimi i kërkesës/shkresës zyrtare pranë MFE duhet ndjekur me vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta me stafin përkatës në MFE. Krahas projekt idesë, në rastin e nevojës për investime, do të duhet të shoqërohet edhe me nevojat për asistencë teknike për të përgatitur projektin (studim fizibiliteti/projekt teknik) sikurse dhe nevojat afatgjata për të mirëmbajtur produktet e projektit. Pavarësisht faktit që Bashkia nuk mund të negociojë drejtpërdrejtë me donatorët, duhet ti kërkohet MFE që të mundësojë pjesëmarrjen kur diskutohet kërkesa juaj dhe siguroni që Bashkia i ka kapacitetet për ta zbatuar atë.

NË VËMËNDJE!

- ▶ Kërkesa për financim të huaj si grant edhe kredi duhet të shkojë detyrimisht nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj).
- ▶ Siguroni që projekti është i përfshirë në Programin Buxhetor Afatmesëm të bashkisë tuaj si dhe garantoni bashkëfinancimin, nëse ka, apo parashikimin e TVSH.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni që:

- ▶ Garanton zbatimin e Kuadrit Ligjor për financimet e Huaja si dhe koordinon procesin e sigurimit të financimeve në përputhje me proritetet sektoriale.
- ▶ Harton kuadrin makroekonomik, përcakton limitin e kredimarrjes dhe ndikon në shumën e financimit të huaj në bazë kredie.
- ▶ Drejton dhe/ose bashkëdrejton me Minsitritë e Linjës dhe Institucionet e tjera publike negociatat me Partnerët për Zhvillim dhe Integrim.
- ▶ Miraton financimin (si grant ashtu edhe kredi) dhe siguron përfshirjen e tij në Programin Buxhetor Afatmesëm.

KUJDES:

Çdo përpjekje për të siguruar financimin e projekteve jashtë ciklit buxhetor dhe institucional nuk do të jetë e suksesshme.

2.2 Tipologjia e projekteve për financim të huaj

Tipologjitë e projekteve për të cilat mund të sigurohet një financim i huaj

PËRGATITJE PROJEKTESH: Asistencë Teknike për përgatitjen e projekteve të investimit ku përfshihet:

- ▶ Vlerësimi i nevojave dhe identifikimi i ndërhyrjeve konkrete
- ▶ Përgatitjen e studimeve pre-fizibiliteti dhe fizibiliteti;
- ▶ Projektimi teknik i detajuar, përgatitja e dosjes së tenderit dhe asistenca në procesin e tenderimit për komponentët të identifikuar si pjesë e projektit.

Në raste të donatorëve si Bankat (Institucionet Financiare), të cilat ofrojnë vetëm kredi, përgatitja e projektit dhe AT për konsulencë sigurohet nga Portofoli i Kredisë ose nga bashkëfinancimi me grant i donatorëve bilateralë dhe BE.

INVESTIME: Financim për realizimin e projekteve të investimit ku përfshihet:

- ▶ Kryerja e Investimit në infrastrukturë
- ▶ Supervizion i projektit
- ▶ Ekipin mbështetës me ekspertë /teknikë

Investimet mundësohen me fonde Grant nga IPA, donator bilateralë, fonde Kredi nga Bankat ose Bashkëfinancime Grant & Kredi (pool funding).

Në rast të financimeve të huaja me kredi performanca Financiare e Bashkisë dhe aftësia paguese janë KUSHT.

NGRITJE KAPACITETESH: Fonde Grant ose Asistencë Teknike për mbështetje insitucionale ku përfshihet:

- ▶ Konsulencë për përgatitje strategjish, raporte monitorimi, studime sektoriale.
- ▶ Ekspertë për përgatitje të rregulloreve për kryerjen e funksioneve të caktuara.
- ▶ Trajnimet specifike dhe të përgjithshme.

Mbështetja për ngritje kapacitetesh mundësohet me fonde Grant kryesisht të BE/ IPA ose donatorët bilateralë.

Trajnimet ofrohen nga Agjensi të Specializuara dhe kryhen në bashkepunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike- ASPA.

Identifikimi dhe përgatitja e një projekti investimi

Programimi i një projekti për financim bazohet në strategjinë e zhvillimit të sektorit ku përcaktohen përparësitë dhe objektivat strategjike. Më pas vijohet me përgatitjen sipas këtyre fazave (i) Identifikim i nevojës; (ii) përgatitja e projekt-idesë; (iii) konsultimi dhe miratimi në parim (iv) negociatat dhe miratimi final;

Në fazën e programimit, donatorët angazhojnë fonde grant për të përgatitur projektin që përfshin:

- Vlerësimin e nevojave dhe identifikimin e ndërhyrjeve konkrete.
- Përgatitjen e studimeve pre-fizibiliteti dhe fizibiliteti;
- Projektimi teknik i detajuar, përgatitja e dosjes së tenderit dhe asistenca në procesin e tenderimit për komponentët të identifikuar si pjesë e projektit.

Përgatitja e projekteve mund të realizohet edhe nga institucionet qendrore si: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, (FZSH); Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve (AKUK), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me fonde të donatorëve ose të buxhetit.

Në fazën e zbatimit, donatorët angazhojnë fonde për të realizuar investimin që përfshin:

- Ndërhyrje në infrastrukturë
- Supervizion dhe ekspertë që garantojnë cilësinë dhe standartet e punimeve.

Në rastin e financimit me grant, përgatitja e projektit është pjesë përbërëse e marrëveshjes së projektit që do të financohet nga donatori. Në rastet e programeve/projekteve të financuara nga disa donatorë, osë me bashkëfinancim, përgatitja e projektit realizohet nga donatori i besuar për zbatimin (p.sh. KFW për investimet në Ujësjellës-Kanalizime të financuara nga disa donatorë si BE, Austria, Zvicra etj).

Në rastet e financimeve nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFI), ose Bankat, të cilat ofrojnë vetëm kredi, përgatitja e projektit dhe Asistencës Teknike për konsulencë sigurohet nga:

- Portofoli i kredisë; Fonde grant në vlera të vogla që vetë Banka ofron në disa raste, si p.sh. BB; KFW, BERZH të cilat i paraprijnë investimit me kredi.
- Bashkëfinancimi me grant i donatorëve bilateralë dhe BE.
- Trust Funde Rajonale ku Bankat aplikojnë për të siguruar grant për përgatitje projekti.

Në varësi të tipologjisë së projekteve investimi mundësohet përmes ndërthurjes sa më mirë të mekanizmave financiarë që janë grantet e ofruara kryesisht nga BE/ IPA dhe donatorët dy-palësh me kreditë e financuara nga Bankat ose Institucionet Financiare Ndërkombëtare. Kjo ndikon në zbutjen e termave të kredisë duke lehtësuar procesin e huamarrjes dhe ruajtjen e nivelit të Borxhit Publik sipas parametrave Makro-Ekonomikë të miratuar nga Qeveria.

Në rast të programeve me disa ndërhyrje, që shtrihen në disa bashki dhe për një numer të madh investimesh procesi i përgatitjes së programit të investimit dhe dizenjimit udhëhiqet nga Ministria e Linjës përkatëse apo Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me donatorin/ët dhe përfituesit e fundit që janë bashkitë/qarqet. Këtu mund të përmëndim Programet e Infrastrukturës së Bashkive (Municipal Infrastructure) për rikonstrukcionin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, apo i rrugëve lokale/rurale të shtrira në disa bashki. Këto programe financohen nga disa donatorë me bashkëfinansim edhe të Qeverisë Shqiptare dhe zbatohen nga donatori i besuar si KFW apo Banka Botërore, sipas marrëveshjes përkatëse.

Kalimi nga qasja me bazë projektë në qasje me bazë sektori ose programi

Vitet e fundit donatorët dhe Qeveria kanë avancuar në alokimin e ndihmës së huaj duke e programuar atë në bazë sektori dhe jo projektë. Ky proces filloi që me inicimin e Qasjes Sektoriale dhe mbështetjes buxhetore të ofruar nga BE në kuadër të IPA II 2014-2020.

Qasja sektoriale bazohet në një program të vetëm gjithëpërfshirës që përfshin veprime dhe aktivitete specifike, me afate kohore dhe kosto të përcaktuar në nivel kombëtar dhe rajonal për zhvillim e sektorit si p.sh. në infrastrukturë, shëndetësi, arsim ose bujqësi.

Qëllimi kryesor i qasjes sektoriale është definimi i Programeve Strategjike Kombëtare dhe përkthimi i tyre në programe sektoriale tre vjecare, që kanë në përbërje një seri projektesh individuale të natyrës së investimit publik dhe asistencë teknike, të nevojshme për të mbështetur refoma të rëndësishme në sektor.

Në përfundim të këtij procesi, hartohen një numër programesh investimi apo ngritje kapacitetesh (asistencë teknike) të cilat mbulojnë një prioritet të caktuar të gatshme për tju prezantuar donatorëve dhe më gjerë (p.sh me Partneritet Publik Privat) në mënyrë të integruar për financim si dhe përfshirja e tyre në Programin Buxhetor Afatmesëm e më tej në atë vjetor.

Ekzistojnë disa mekanizma për financimin e qasjes sektoriale

- *Bashkimi i të gjitha fondeve në një protokol (Pool Funding)*, mundësohet nga kontributi i disa donatorëve në një program të caktuar. Në këtë rast donatorët pjesëmarës bien dakord për të kaluar të drejten e menaxhimit të fondit tek njëri prej tyre. Donatori të cilit i besohet menaxhimi i fondit me procedurat e tij, zbaton, monitoron dhe raporton regullisht tek donatorët e tjerë dhe institucionet shqiptare mbi ecurinë e financimit dhe zbatimit të projektit (*Psh. praktikë e Bankës Botërore, BE, KFW*).
- *Mbështetja buxhetore*, nënkupton një transferim të burimeve financiare nga donatori drejt buxhetit të vendit në mbështetje të sektori/programi të caktuar, bazuar në dokumenta të miratuara të reformës sektoriale dhe e limituar në kushte të paracaktuara. Fondet e disbursuara nga donatori menaxhohen nga sistemi vendas i Menaxhimit të Financave Publike dhe raportohet tek donatori në bazë të treguesve dhe rezultatet e arritura. (*Psh.*

praktikë e Bankës Botërore, IPA dhe FMN).

- *Partneriteti Publik-Privat:* Instrumenta financiarë në mbështetje të huamarrjes nga privati për aktivitete zhvillimore specifike si ofrim i garancive bankare, pjesëmarrje në joint venture, hua të drejtëpërdrejta për biznesin, etj. (Praktike e Institucioneve Financiare Ndërkombëtare).

Vendimi për llojin e instrumentit të ndihmës që ofrohet nga një donator i caktuar varet nga: (i) politika e tyre mbi ndihmën; (ii) perspektiva mbi dialogun dhe llogaridhënien e qeverisë në përgjithësi; (iii) kapaciteti organizativ dhe institucional i vendit për ta zbatuar; dhe (iv) besimi në procedurat e qeverisë për menaxhimin financiar.

2.2 Procesi i negociimit dhe miratimit të Marrëveshjeve Qeveritare

Partnerët për Zhvillim dhe Integrim në konsultim me Qeverinë Shqiptare hartojnë Dokumentat Strategjike për Vendin ku definojnë prioritetet për alokimin e burimeve të tyre financiare për Shqipërinë. Dokumentat Strategjike në pjesën më të madhe shtrihen për një periudhë katër deri shtatë vjecare si dhe përcaktojnë tipologjinë e mbështetjes, kuadrin institucional dhe burimet financiare që do të alokohen.⁵

Periudha e negociimit dhe miratimit të marrëveshjeve apo protokolleve qeveritare varion sipas procedurave të cdo donatori dhe sipas një kalendari të rënë dakord paraprakisht.

Bazuar në Dokumentin Strategjik për Vendin apo dokumenta të tjerë politikë të ndihmës, vijohet me Negociatat Bilaterale për përcaktimin e programeve dhe projekteve konkrete që do të financohen, për të cilat hartohen Marrëveshjet dhe/ose Protokollet Qeveritare.

Komiteti i Planifikimit Strategjik, si struktura më e lartë vendimarrëse miraton programet afatgjata, aftamesme dhe vjetore të financimeve të huaja në përputhje me përparësitë strategjike të zhvillimit dhe integritimit evropian;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është institucioni kryesor që koordinon procesin e brendshëm të identifikimit, vlerësimit dhe analizimit të relevancës së projekteve/programeve të propozuara nga Institucionet Shqiptare. Pas miratimit të listës së projekteve prioritare është institucioni që kryeson negociatat me Partnerët për Zhvillim dhe Integrim.

Në këtë fazë të programimit rol kyç për të propozuar dhe negociuar prioritetet e tyre sektoriale për financim nga donatorët kanë institucionet qëndrore si Minsitritë e Linjës apo Agjencitë në varësi.

Qeverisja vendore nuk është pjesë e drejtpërdrejtë e negociatave qeveritare por roli i tyre është që të ndikojnë në përfitimin nga financimet e huaja nëpërmjet “lobimit aktiv” me: (i) Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Linjës sipas sektorëve prioritare; (ii) Agjencinë për Mbështetjen e Vet-Qeverisjes Vendore (AMVV), e cila më pas i transmeton këto prioritetet në emër dhe në interes të bashkive.

Bashkitë nuk mund të negociojnë drejtpërdrejtë me donatorët. Kërkesa zyrtare në rastet kur financimi kërkohet në kuadër të Bashkëpunimit ndërqeveritar duhet detyrimisht të kalojë përmes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrive të tjera të Linjës apo AMVV.

Pas rënies dakord me donatorin për programet apo projektet që do të financohen si dhe pas miratimit nga Komiteti i Planifikimit Strategjik vijohet me ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e marrëveshjeve përkatëse si më poshtë.

⁵ Kohëzgjatja e dokumentave strategjike dhe niveli i financimeve varion sipas politikave dhe prioritetëve të donatorëve në kuadër të Bashkëpunimit për Zhvillim.

MANUAL UDHËZUES PËR KOORDINIMIN E FINANCIMEVE TË HUAJA NË NIVEL VENDOR

Marrëveshjet Kuadër Ndërqeveritare

Marrëveshje disa vjecare mbi fushat e bashkëpunimit dhe parimet e përgjithshme dhe Protokolle Bashkëpunimi



Miratimi në Këshillin e Ministrave

Ministria e Financave dhe Ekonomisë paraqet marrëveshjen për miratim në Këshillin e Ministrave pasi ka ndjekur procedurat ligjore (përgatitja e projekt VKM, relacionin dhe marrjen e mendimeve nga institucionet e tjera)



Ratifikimi në Parlament

Minsitria për Evropën dhe Punët e Jashtme vijon me dërgimin e marrëveshjes për ratifikim me ligj në Parlament (në rast se Marrëveshja e Finacimit është me Hua si dhe kur parashikon përjashtime nga taksat dhe TVSH)

22

2.2 Procesi i negociimit dhe miratimit të Marrëveshjeve Qeveritare

Marrëveshjet për Projektin

Marrëveshje Qeveritare, Financiare dhe Teknike, për miratimin e një projekti të caktuar ose programi me disa ndërhyrje me financime Hua dhe /ose Grant.



Miratimi në Këshillin e Ministrave

Ministria e Linjës Përfituese në bashkëpropozim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë paraqesin marrëveshjen për miratim në Këshillin e Ministrave pasi kanë ndjekur procedurat ligjore (përgatitja e projekt VKM, relacionin dhe marrjen e mendimeve nga institucionet e tjera).



Ratifikimi në Parlament

Minsitria për Evropën dhe Punët e Jashtme vijon me dërgimin e marrëveshjes për ratifikim me ligj në Parlament (në rast se Marrëveshja e Finacimit është me Hua si dhe kur parashikojnë përjashtime nga taksat dhe TVSH)



ZBATIMI I PROJEKTEVE

Ministritë e Linjës Përfituese; Institucione të tjera Qëndrore Publike; Institucione vendore (Zyra rajonale, Bashki, Qarqe)

2.4 Partnerët për Zhvillim dhe Integrim dhe programet e tyre

Financimi i huaj është një instrument shumë i rëndësishëm për mbështetjen e reformave që Qeveria Shqiptare ndërmerr e perkthyer kjo në financimin e një serie projektsh me impakt të drejtëpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Asistenca e huaj akordohet nga Partnerët për Zhvillim dhe Integrim, të njohur me termin Donatorë, të cilët ndahen në dy kategori të mëdha: donatorë Shumëpalësh (multilateralë) dhe donatorë dy-palësh (bilateralë). Në përqindje asistenca financiare më e madhe jepet nga donatorët shumëpalësh (shkon deri në 70 me 30 % përkundrejt donatorëve dy-palësh).

Donatorët shumëpalësh me portofolin më të rëndësishëm janë:

- Bashkimi Europian dhe Banka Botërore.

Donatorët dy-palësh kryesorë janë:

- Gjermania, Italia, Zvicra, SHBA, Japonia, Suedia, Austria, Turqia, dhe Holanda.

Donatorë të tjerë dhe Agjenci Zbatimi janë:

- Kombet e Bashkuara (Agjencitë e UN), Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), Këshilli i Evropës etj.

Institucione Financiare Ndërkombëtare (IFI) kryesorë janë:

- Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Europiane e Investimeve (BEI), Banka e Këshillit të Evropës (CEB), Banka Islamike e Zhvillimit (IDB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Fondi Kuvajtjan, Fondi Saudit etj.

SEKTORËT E MBËSHTETUR NË NIVEL VENDOR ME FINANCIM TË HUAJ

Pjesa më e madhe e projekteve të investimit të financuara deri më tani nga donatorët, dhe ato

që po planifikohen, pavarësisht programimit në nivel qendror, zbatohen në nivel vendor dhe shtrihen në gjithë territorin e vendit duke mbuluar pothuaj 61 Bashkitë.

Projektet me financim të huaj ku përfitues dhe administrues janë vetë Njësitë e Qeverisjes Vendore/ Bashkitë mbulojnë këto sektorë kryesorë:

Ujësjetës-Kanalizime dhe Transporti janë sektorët me fonde më të mëdha të alokuara nga komuniteti i donatorëve, (kredi dhe grant). Donatorët më të mëdhenj në sektorin e Ujësjetës Kanalizime janë BE/IPA dhe Gjermani/KFW, ndërsa në Transport dominon më së shumti financimi nga institucionet financiare si BEI, BERZH, IDB, CEB, etj.

Arsimi dhe Formimi Profesional Me financim kredi dhe grant janë mundësuar kryesisht nga institucionet financiare si CEB, EIB dhe Banka Botërore të cilët janë edhe donatorët më potencial për nga vlera e financimit në këtë sektor. Ndersa donatorët dypalësh si Zvicra, Italia, Gjermania por edhe BE jane angazhuar fuqishëm në zhvillimin e arsimit profesional dhe qëndrave te formimit.

Bujqësia: Sektori i Bujqësisë mbështet me financime grant nga IPA kryesisht në sektorin e sigurisë ushqimore ndërsa Banka Botërore është donatori më i madh i investimeve për sektorin e Ujitjes dhe Kullimit. Donatorë të tjerë bilateralë gjithashtu të angazhuar në këtë sector janë Gjermania/GIZ dhe Italia.

Mjedisi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve: Me financime të konsiderueshme grant dhe kredi donatorët kryesrë të angazhuar në mjedis janë BE/IPA dhe Banka Botërore. Ndërsa Gjermania përmes KFW ka ndërmarrë një sërë projektsh të rëndësishme për investime në ngritjen e infrastrukturës së menaxhimit të Integruar të mbetjeve në nivel rajonal.

Decentralizimi dhe Zhvillimi Rajonal: Pas reformës Administrative Territoriale dhe në zbatim të Strategjisë së Decentralizimit një numër i madh donatorësh janë angazhuar në këtë sektor duke mbështetur me asistencë ne ngritjen e kapaciteteve të bashkive për ushtrimin e funksioneve si dhe investime në infrastrukturë. Donatorët ryesorë janë Zvicra, USAID, Italia, Austria, BE dhe PNUD kryesisht me fonde të angazhuara grant.

Strehimi, Planifikimi Urban dhe Kujdesi & Përfshirja Sociale: Ky sektor mbështetet me kredi nga Banka e Këshillit të Evropës (CEB) për strehim social në Shqipëri. Donatorë të tjerë si Italia, Japonia dhe BE/IPA janë fokusuar në përmirësimin e shërbimeve sociale publike lokale si dhe infrastrukturën për grupet në nevojë në zonat periurbane.

Shëndetësia Donatorët kryesorë në këtë sektor janë Banka Botërore me financime kredi për mbështetjen e Reformës së Kujdesit dhe Sigurimit Shëndetësor si dhe Italia e angazhuar në rehabilitimin dhe pajisjen e poliklinikave në disa bashki si Dibër, Korçë, Gjirokastër dhe Tiranë.

Informacion mbi donatorët kryesorë, programet e tyre dhe Agjencitë e Zbatimit

DONATORË SHUMËPALËSH

BE/KOMMISIONI EUROPIAN



Delegacioni I BE-së në Shqipëri

https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en

IPA II 2014-2020⁶ është instrumenti kryesor financiar i BE-së në mbështetje të vendeve në procesin e para-aderimit dhe plotësimit të kushteve për anëtarësim në BE. Financimi për Shqipërinë për këtë periudhë arrin në shumën prej 649.4 million €. Sektorët prioritarë janë: (i) Demokracia dhe Qeverisja; (ii) Shteti i së Drejtës dhe të drejtat Themelore; (iii) Mjedisi dhe masat për klimën; (iv) Transporti; (v) Konkurrueshmëria dhe Inovacioni; (vi) Arsimi Punësimi dhe politikat sociale; (vii) Bujqësia dhe Zhvillimi Rural; (viii); Bashkëpunimi rajonal dhe Territorial.

KOMBET E BASHKUARA



<https://www.un.org.al/>

Agjensitë e Kombeve të Bashkuara veprojnë në shqipëri bazuar në Programin e Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2017-2021⁷, i cili përcakton katër fusha kryesore të ndërhyrjes: (i) Qeverisja dhe Shteti Ligjor; (ii) Kohezioni Social në shëndetësi, arsim, mbrotja sociale, mbrotjen e fëmijëve dhe ndaj dhunës me bazë gjinore; (iii) Rritja

ekonomike, punësimi dhe bujqësia; (iv) Mjedisi dhe ndryshimet klimatike. Financimi i programeve dhe projekteve të UN në Shqipëri, mundësohet nga tre burime financiare, me burime të veta (Core funds dhe të Agjencive) me fonde grant nga BE dhe donatorëve të tjerë si dhe bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare. Agjensitë e UN ofrojnë ekspertizë të specializuar në fushat e tyre të kompetencës ndaj edhe mandatohen të zbatojnë projekte të deleguara dhe fiancuara nga donatorë të tjerë përmes marrëveshjeve specifike të zbatimit.

BANKA BOTËRORE



Zyra e Bankës Botërore në Tiranë

<https://www.worldbank.org/en/country/albania>

Strategjia e Partneritetit për Vendin (CSP) 2015-2019⁸, është dokumenti bazë ku përcaktohen prioritetet e BB për Shqipërinë të shtrira deri në vitin 2020. Sektorët kryesorë të mbështetjes janë: (i) Qëndrueshmëria fiskale dhe ruajtja e stabilitetit financiar; (ii) Krijimi i një mjedisi biznesi me cilësi të lartë; (iii) Ofrimi i energjisë së pastër, efciente, të barabartë dhe financiarisht të qëndrueshme; (iv) Formalizimi dhe rritja e gjithëpërfshirjes dhe qëndrueshmërisë së sektorit të tokës; (v) Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë; Njëpërmjet kësaj strategjie fianancohen rreth 12 projekte me një fond kryesisht kredi në vlerën prej 738 million USD.

6 Regulation (EU) No 231/2014 of the European Parliament and of the Council of 11 March 2014 establishing an Instrument for Pre-accession Assistance (IPA II)

7 <https://www.un.org.al/sites/default/files/2017%20UNDAF%20%28Workplan%29%20Mid%20Year%20Review.pdf>

8 <https://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Albania/al-cpf-2015-al.pdf>

DONATORË DYPALËSH

ITALIA



Italian Agency for Cooperation and Development (AICS)

<http://aicstirana.org/en>

Protokolli Dypalësh i Bashkëpunimit 2014-2016⁹ Shqipëri–Itali është dokumenti aktual ku përcaktohen prioritetet dhe financimet e sektorëve prioritarë strategjikë: (i) Zhvillimi i Qëndrueshëm, përmirësimi i Konkurrueshmërisë dhe përdorimi eficient i burimeve; (ii) Zhvillimi, përfshirja sociale dhe kohezioni territorial; (iii) Mirëqeverisja, Demokracia dhe Shteti i së drejtës. Italia ka financuar deri më tani në Shqipëri 41 projekte me një shumë totale prej rreth 300 milion euro (260 milion Euro kredi e butë; 20 milion grant dhe 40 milion përmes instrumentit të konvertimit të borxhit).

GJERMANIA

Bashkëpunimi për zhvillim me Gjermaninë dhe prioritetet për financim përcaktohen në protokollet dypalëshe të cilat negocohen çdo dy vjet përmes bisedimeve teknike dhe qeveritare. Zbatimi i financimeve nga Gjermania mundësohet përmes dy organizmave të saj prezent dhe në Shqipëri: Zyra e Bashkëpunimit Teknik-GIZ dhe Banka Gjermane për Zhvillim-KFW.



Zyra e GIZ në Shqipëri

<https://www.giz.de/en/worldwide/294.html>

GIZ zbaton projekte të bashkëpunimit teknik me fonde grant të qeverisë Gjermane në sektorët prioritarë: (i) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; rritja e konkurrueshmërisë së kompanive; përmirësimi i klimës së investimeve dhe përafrimi i legjislacionit ekonomik me acquis; nxitja e trainimit profesional. (ii) Bujqësia dhe Zhvillimi rural; rritja e produktivitetit në bujqësi; punësimi dhe fuqizimi i turizmit në zonat rurale. (iii) Uji dhe mbetjet urbane: mbështetje për riskstrukturimin e institucioneve në sektorin e ujit, Asistencë teknike për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Bashki, mbështetje për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Bashki;



Zyra e KfW në Tiranë

<https://www.kfw-entwicklungsbank.de/International-financing/KfW-Development-Bank/Local-presence/Europe/Albania/>

KfW është Institucion Financiar (Bankë) e cila mbështet kryesisht me financime kredi, projekte infrastrukturore në sektorë me rëndësi të veçantë si (i) Energjia: eficiencia e energjisë dhe energjia e rinovueshme; (ii) Infrastruktura bashkiake: (furnizimi me ujë, ujërat e ndotura, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe infrastruktura rurale).

KfW zbaton dhe një numër të madh projektsh rajonale që lidhin Shqipërinë me vendet e rajonit kryesisht në ndërtimin e linjave të transmetimit të Energjisë me Kosovën dhe Malin e zi. Projekte të tjera janë rehabilitimi i stacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë, përmirësimin e sigurisë së digave si dhe të eficiencës së energjisë në ndërtesat publike.

DONATORË DYPALËSH

SHTETET E BASHKUARA



Zyra e USAID në Shqipëri

<https://www.usaid.gov/>

Qeveria e Shteteve të Bashkuara, përmes programit të zhvillimit të USAID-it bazuar në Strategjinë për Bashkëpunimin për Zhvillim me Shqipërinë 2011-2015¹⁰ ofron asistencë në formë granti në këto fusha kryesore: (i) Fuqizimi i Shtetit të së drejtës nëpërmjet rritjes së aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe sigurimit e funksionimit të duhur të gjykatave. (ii) Përmirësimin dhe aftësimin e Qeverisjes vendore për rritjen e të ardhurave dhe ofrimin e më shumë shërbimeve efektive qytetarëve në fusha të tilla si kujdesi shëndetësor, furnizimi me ujë dhe të tjera; (iii) Përmirësimin e konkurrueshmërisë së biznesit dhe fuqizimi i sektorit financiar për të mbështetur më mirë zhvillimin ekonomik dhe sigurinë financiare.

ZVICRA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ambasada e Zvicrës në Tiranë

<https://www.eda.admin.ch/countries/albania/en/home/representations/embassy-tirana.html>

Strategjia e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri 2018-2021¹¹, përcakton drejtimit

10 https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/CDCS_USAID_Albania.pdf

11 https://www.eda.admin.ch/dam/countries/countries-content/albania/en/2018-02-22-albania-coop-strategy_AL-reduced.pdf

The Results Strategy for Reform Cooperation with Eastern Europe, the Western Balkans and Turkey 2014 – 2020

12 The Results Strategy for Reform Cooperation with Eastern Europe, the Western Balkans and Turkey 2014 – 2020

kryesore të mbështetjes zvicerane për Shqipërinë si dhe buxhetet. Bashkëpunimi është i fokusuar në katër fusha prioritare: (i) Qeverisja Demokratike; (ii) Zhvillimi Ekonomik dhe Punësimi; (iii) Infrastruktura Urbane dhe Energjia; (iv) Shëndetësia. Angazhimet financiare të parashikuara për periudhën 2018-2021 arrijnë në vlerën 105 milionë Franga Zvicerane.

Ndihma e qeverisë së Zvicrës është grant dhe zbatohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO). SDC dhe SECO të cilat përfaqësohen nga Ambasada e Zvicrës në Tiranë, bashkërendojnë për zbatimin e pjesëve përkatëse të strategjisë dhe të projekteve që financohen në Shqipëri.

SUEDIA



Ambasada Suedeze në Tiranë

<https://www.sida.se/English/where-we-work/Europe/Albania/>

Bashkëpunimi për Zhvillim me Suedinë bazohet në "Strategjinë e Rezultateve të Bashkëpunimit në fushën e Reformave me Europën Lindore, Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2014-2020"¹². Projektet zbatohen nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunimin për Zhvillim Ndërkombëtar – SIDA. Suedia financon me fonde grant që arrijnë në SEK 100 milion për vit, dhe është e orientuar në tre fusha prioritare: Përmirësimi i integritit ekonomik, fuqizimi i demokracisë, dhe përmirësimi i mjedisit dhe reduktimi i ndikimit të ndryshimeve klimaterike.

DONATORË DYPALËSH

AUSTRIA



Zyra e ADA në Tiranë

<https://www.entwicklung.at/en/countries/south-eastern-europe/albania/>

Bashkëpunimi për Zhvillim me Austrinë, bazohet në Dokumentin Strategjik per Vendin 2015-2020¹³, ku përcaktohen prioritetet për financim në dy sektorë: (i) Menaxhimi i Integruar i Burimeve ujore; (ii) Qeverisja e mirë dhe Shteti i së drejtës. Gjithashtu Austria ofron asistencë për çështje ndërsektoriale si mjedisi dhe klima, barazia gjinore dhe përfshirja sociale. Ndihma zbatohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), kryesisht në formë granti përmes projekteve të bashkëpunimit teknik. Austria ka ofruar edhe kredi me terma të buta në sektorin e Teknologjisë së Informacionit e Koomunikimit dhe Shëndetësisë përmes një marrëveshje të veçantë me Ministrinë e Financave Austriake.

JAPONIA



Japan International Cooperation Agency

Zyra e JICA për Ballkanin

<https://www.jica.go.jp/albania/english/index.html>

Qeveria Japoneze, përmes JICA ofron mbështetje në formë granti dhe kredi me terma të buta si dhe asistencë teknike. Asistenca e JICA për bashkëpunimin teknik mbulon disa fusha prioritare si: Bujqësia, zhvillimi i Infrastrukturës, kujdesi shëndetësor, arsimit dhe mjedisi. Veçanti e JICA është ofrimi cdo vit i një numri të konsiderueshëm trajnimësh në Japoni për zyrtarë të institucioneve publike. Nëpërmjet këtyre programeve të trajnimit JICA në bashkëpunim me institucionet e qeverisë japoneze, qeverisjen vendore, bizneset dhe universitetet i mundëson specialistëve dhe zyrtarëve shqiptarë përfitim të njohurive dhe ekspertizës së kualifikuar për tu ushtruar në Shqipëri.

Aneksi 1: Formulari i Prezantimit të Projekt - idesë

01. Referencat

Sektori			
Referenca e Dokumentit Strategjik		Bashkia	
Programi (sipas PBA)		Vendi/zona e Projektit	

02. Identifikimi i Idesë së Investimit/Asistencës teknike

Projekt idea(titulli i projektit)	
Problemet që duhen adresuar	
Qëllimet, objektivat, prioritetet e Strategjisë/Programit që do të arrihen me ndihmën e Projektit	
Aktivitetet e Projektit	
Informacione të tjera	

0.3. Kostimi i Projektit Investim/TA ne lek ose Euro

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Total	TA/Investim
Kostimi Total i Projektit					
Kontributi i Buxhetit të Shtetit					
Financimi i Kërkuar nga Donatorët					

